



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**  
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.777/13

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm** (e vendosur ne objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), e përbërë nga gjyqtari individual, **Faton Ademi**, me procesmbajtësen Elheme Peci në çështjen juridike të paditësve: dhe nga të cilat i përfaqëson kundër të paditurit: nga të cilin e përfaqëson Av. nga baza e kontestit: Mbajtje Financiare dhë Ushqimi, pas mbajtjes së seancës kryesore të datës: 25.02.2014 me datën 28.03.2014 bie këtë:

**A K T G J Y K I M**

- **APROVOHET** pjesërisht si e Bazuar kërkespadia e paditësve dhë nga dhe
- **OBLIGOHET** i padituri që në emër të mbajtjes financiare përfëmijët e tij t'ia paguajë të njëjtave shumën prej 50 euro( nga 25 për secilën) në muaj brenda afatit 15 ditë, pas plotë fuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm
- Pjesa tjetër përtëj shumës së aprovuar Refuzohet si e **PA BAZUAR**
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

**A r s y e t i m**

Paditëset me datë: 06.12.2013 kanë parashtruar në gjykatë padë me anë të së cilës kanë kërkuar nga gjykata që ta obligon të paditurin që në emër të kontributit për mbajtje financiare t'ia paguajë paditësve shumën prej 250 euro.

*E. Bajraktari*  
28.03.14

Në seancën e datës: 05.02.2014 e autorizuara e paditësve deklroi se është jeshuar një gabim teknik, pasi shuma e kërkuar për dy vajzat duhet të jetë 170 euro, shpenzi met e procedurës i kërkoi.

I padituri në seancën e datës: 05.02.2014 deklroi se e kundërshtoi kërkesëpadinë pasi që nuk ka mundësi të paguajë, ndërsa paditëset gjithashtu tani kanë mbushur moshën madhore, ndërsa gjykatës në seancën e ardhshme do të ia sjell provat tjera të cilat do të vërtetohën se unë nuk kam mundësi të paguajë shumën e kërkuar.

Në seancën kryesore e autorizuara e paditësve ka dekluarar se mbetet në tërësi pranë të cekurave në seancën e kaluar.

I autorizuari i të paditurit ka dekluarar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazë juridike dhe pa mbështetje faktike nga faktet si në vijim me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë C.Nr. dt.22.02.2013, gjithashtu potencoi faktin se paga e të paditurit nuk ka ndryshuar është e njëjtë siç ka qenë pre koeficienti 6 me pagë mujore prej 360 euro.

I padituri ka marrë kredi konsumuese në Bankë dhe atë me dt.16.08.2013 në shumë prej 5 000 euro në afat kthimi prej 36 muaj, ku rata mujore e kthimit të kredisë është 161.71 euro nga shuma e përgjithshme prej 360 euro zbritet alimentacioni për fëmijun e mitur në shumë prej 150 euro si dhe shuma për kreditinë konsumuese mujore prej 161.81 euro të paditurit i mbetet që të kaloi muajin vetëm në shumën prej 41.19 euro.

Gjykata në seancën kryesore administroi këto prova: marrëveshja mbi kreditinë konsumuese e lidhur në mes të të paditurit dhe dt.16.08.2013, aktgjykimi me numër C.Nr. e dt.22.02.2013, kontrata e punës e lidhur në mes të të paditurit dhe Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë e dt.01.04.2013, pasqyra mbi ndalesat në emër të kredisë për të paditurin.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe në raport me njëra tjetrën konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto përfundime.

Pas administrimit të këtyre provave gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar për arsy që do të paraqiten më poshtë:

Nuk është kontestuese se fëmijët e përbashkët pra paditëset me aktgjykimin e mëhershme të Gjykatës në Mitrovicë i jan besuar në mirërritje dhe edukim nënës së tyre.

Paditëset kanë kërkuar mbajtje financiare pas moshës 18 vjeçare për nevojat e shkollimit.

Sipas Ligjit për Familjen i Kosovës prindërit kanë për obligim mbajtjen e fëmijëve deri në moshën 18 vjeçare si moshë madhore, mirëpo ky obligim mund të vazhdoj edhe pas kësaj moshe nëse fëmijët nă vazhdim të shkollimit.

Në rastin konkret i padituri ka për obligim të ofroj mbajtje financiare për fëmijët e rritura paditëset për shkak se të njëjta janë në vazhdim të shkollimit.

Në rastin e përcaktimit iç shumës gjykata ka parasysh faktin e mjeteve me të cilat jeton prindi tek i cili nuk janë fëmijët.

Në rastin konkret paditësi realizon pagë prej 360 euro, ku kjo vërtetohet në bazë të kontratës së punës.

Paditësi nga kjo shumë ka obligim finançiar ndaj bankës që në emër të kredisë të paguajë kësttin mujor prej 161 euro, ndërsa poashtu i njëjtë ka për obligim që në emër të alimentacionit të paguajë shumën prej 75 euro.

Gjykata vendosi që pjesërisht ta aprovoi kërkesëpadinë e paditësve, pasi me aprovomine tërësishtëm të shumës së kërkuar do të rrezikohej mirëqenia e të paditurit.

Sa i përket të drejtës materiale gjykata u bazua në nenet: 289, 290 dhe 280 të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale e mori në bazë të nenit 452.2 të LPK-së duke marrë për bazë suksesin e arritur në procedurë vendosi që secila palë ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Andaj, gjykata konform nenit 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË,  
C.nr. 777/2013 me dt. 28.03.2014**

**GJYQTARI,**  
**Faton Ademi**

*Haxhi*

**UDHËZIM PËR MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.

REPUBLICA FEDERATIVA DEL KOSOVA

PROSECUTOR GENERALI  
PROSECUTOR GENERALI SUD

18.04.2014

*Adem*